



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 110, Datë 27.07.2017**

**MBI**

**MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN/KLASIFIKIMIN E  
SISTEMEVE TË MBYLLURA TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE”.**

Në mbështetje të nenit 71 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi “Rregulloren për përcaktimin/klasifikimin e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

**Konstatoi,**

- ERE me vendimin nr. 105, datë 23.06.2016 ka filluar procedurat për miratimin e “Rregullores për përcaktimin/klasifikimin e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike” dhe ka realizuar procesin e konsultimit me palët e treta në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Me shkresën, nr. 26/34 Prot., datë 25.06.2016, ERE publikoi për 3 ditë me rradhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të Bordit, duke filluar nga data 25.06.2016.
- Po ashtu me shkresën nr. 500 Prot., datë 30.06.2016, ERE dërgoi draft – rregulloren për përcaktimin/klasifikimin e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike, për marrje mendimi, pranë subjekteve: Autoriteti Portual i Durrësit, MEI, Autoritetit i Konkurrencës, Albpetrol sh.a., FIIA, AREA dhe AAES.
- Pas përfundimit të afatit 15 ditor të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara, rezultoi se janë paraqitur në ERE mendime nga Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti Portual i Durrësit dhe Albpetrol sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të miratojë “*Rregulloren për përcaktimin/klasifikimin e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike.*”
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ANËTARI I BORDIT TË ERE**  
**Adriatik BEGO**

# RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN/KLASIFIKIMIN E SISTEMEVE TË MBYLLURA TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

## KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 71 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike si dhe në përputhje me nenin 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE.

### Neni 2 Qëllimi i Rregullores

Kjo Rregullore përcakton kushtet dhe procedurat që zbatohen nga ERE për klasifikimin e një sistemi shpërndarje si sistem i mbyllur, formën e aplikimit, dokumentacionin mbështetës që shoqëron aplikimin, mënyrën e mbajtjes së regjistrit të sistemeve të mbyllura si dhe kushtet dhe procedurat për revokimin e statusit si sistem i mbyllur i shpërndarjes.

### Neni 3 Përkufizime

“Enti Rregullator i Energjisë” - ose “ERE” është autoriteti rregullator i sektorëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

“Bordi”- është organi vendimmarrës i ERE.

“Sistemi i mbyllur i shpërndarjes” - është një sistem i cili shpërndan energji elektrike brenda një zone gjeografikisht të kufizuar industriale, tregtare apo shërbimesh të përbashkëta, nga i cili nuk shpërndahet energji për klientët familjarë ose klientët jo-familjarë të vegjël dhe nëse:

- a. Për arsye të veçanta teknike apo të sigurisë, veprimtaritë ose proceset e prodhimit të përdoruesve të këtij sistemi janë të integruara; ose
- b. Ky sistem shpërndan energji elektrike kryesisht te pronari, tek operatori i sistemit të mbyllur apo shoqëri të lidhura me të.

“Operatori i Sistemit të mbyllur të shpërndarjes” – është operatori që ushtron aktivitetin sipas licensës për sistemin e mbyllur të shpërndarjes dhe rregullave përkatëse të funksionimit të miratuara nga ERE.

**Neni 4**  
**Kushtet për klasifikimin e sistemit të mbyllur të shpërndarjes**

- (1) Sistemi i mbyllur i shpërndarjes duhet të plotësojë këto kushte:
- a) Asetet fizike të shpërndarjes së energjisë elektrike në zonë të jenë në pronësi të personit që aplikon për klasifikimin si sistem i mbyllur i shpërndarjes.
  - b) Të ketë një pikë lidhjeje dhe matje të përcaktuar në marrëveshjen e lidhjes me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
  - c) Numri i klientëve të lidhur me sistemin e mbyllur të shpërndarjes të mos jetë jo më i vogël se XX dhe jo më i madh se XX ose sasia e energjisë elektrike e konsumuar gjatë një viti nga konsumatorët në territorin e mbuluar nga sistemi i mbyllur i shpërndarjes, nuk duhet të kalojë ....% të konsumit vjetor total të të gjithë klientëve në vend.
- (2) Në rast se Sistemi i Mbyllur i Shpërndarjes nuk kërkon përjashtimin e tij sipas pikës 2 të nenit 71, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nga rregullimi i tarifave nga ERE, tarifat e aplikueshme për klientët e lidhur në sistemin e mbyllur do të shqyrtohen dhe do të miratohen nga ERE, në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

**KREU II**

**PROÇEDURAT E APLIKIMIT**

**Neni 5**  
**Dokumentacioni për klasifikimin e sistemit të mbyllur të shpërndarjes**

- (1) Aplikimi për klasifikim në sistemin e mbyllur të shpërndarjes do të depozitohet në ERE nga aplikuesi i interesuar.
- (2) Në formatin e tij të aplikimit, aplikuesi do të shpreh interesin për tu klasifikuar si operator i sistemit të mbyllur të shpërndarjes.
- (3) Përveç formës së aplikimit, nevojitet dorëzimi i dokumentacionit të mëposhtëm shtesë për përmbushjen e kushteve për klasifikimin në sistemin e shpërndarjes:
- a) Ekstrakt nga QKR-ja i shoqërisë tregtare, ku vërtetohet se është e regjistruar në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike;
  - b) Studimi Gjeodezik sëbashku me një ekstrakt të planit kadastral me veçoritë e mëposhtme:
    - Projekti teknik i instalimeve
    - Skicat dhe emërtime të instalimeve, linjave, transformatorëve nga pika e lidhjes në sistemin e transmetimit dhe i shpërndarjes, deri tek pika e lidhjes së përdoruesve të sistemit, duke përfshirë emërtimet e pikave të matjes.
    - Skicat e instalimeve të nevojshme për funksionimin e sistemit të mbyllur të shpërndarjes, dhe

- Skica e infrastrukturës së përdoruesit të sistemit të mbyllur të shpërndarjes prej të cilit mund të përcaktohet saktësisht që është një zonë gjeografikisht e kufizuar;
  - Harta treguese e zonës gjeografike që mbulohet;
- c) Dokumenti që vërteton pronësinë e infrastrukturës sipas pikës 3, gërma b);
  - d) Pronësia mbi asetet fizike të shpërndarjes;
  - e) Leja e ndërtimit të rrjetit;
  - f) Kopje të lejeve të përdorimit dhe dokumentave të tjerë për energjinë si dhe pajisje të tjera në dobi për klasifikimin e sistemit të mbyllur të shpërndarjes. Për pajisjet e amortizuara të cilat nuk kanë lejen e përdorimit, nevojitet një vlerësim nga inspektorë kompetentë në fushat si: sektori i energjisë elektrike, eficienta e energjisë elektrike, mbrojtja ndaj zjarrit dhe shpërthimeve si dhe mbrojtja ndaj ambientit;
  - g) Një listë të përdoruesve të sistemit të mbyllur të shpërndarjes me numrin identifikues të pikës së lidhjes;
  - h) Përshkrimi i mënyrës në të cilën puna apo prodhimi, tregtimi apo aktiviteti i shërbimit të përdoruesit të sistemit të mbyllur të shpërndarjes do të integrohet për shkak të arsyeve teknike apo të sigurisë dhe/ose prova që sistemi i shpërndarjes elektrike parësisht pronarit/zotëruesit apo operatorit të sistemit apo sipërmarrësve të lidhur me to;
  - i) Përshkrimi specifik i sistemit të mbyllur të shpërndarjes;
  - j) Përshkrimi ekonomik i sistemit tregtar apo i shërbimeve të zonës gjeografike të kufizuar ndaj së cilës operatori i sistemit të mbyllur të shpërndarjes do të kryejë aktivitetin;
  - k) Një vërtetim të personave përgjegjës të cilët përfaqësojnë aplikuesin, ku deklarohen se marrin përsipër detyrimin për të ndarë llogarinë e aktivitetit të shpërndarjes në sistemin e mbyllur nga llogaritë e aktiviteteve të tjera në sektorin e energjisë elektrike;
  - l) Një vërtetim nga personat përgjegjës që përfaqësojnë aplikuesin, të lëshuar nga autoriteti kompetent inspektues ku konstatohet se nuk ka asnjë pengesë në mënyrën e operimit të pajisjeve dhe instalimeve që përbëjnë sistemin e mbyllur të shpërndarjes;
  - m) Një vërtetim që i deleguari përgjegjës nuk është përfshirë në një proces të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata);
  - n) Vërtetimin e pagesës rregullatore nga Aplikanti në momentin e paraqitjes së aplikimit, siç përcaktohet nga ERE.

## **Neni 6**

### **Operator i sistemit të mbyllur të shpërndarjes**

1. Operimi i një sistemi të mbyllur të shpërndarjes mund të bëhet nga subjekti ose personi pronar i sistemit të mbyllur të shpërndarjes ose nga një person i tretë i autorizuar ose i kontraktuar nga ai.
2. Personi që merr përsipër operimin e sistemit të mbyllur të shpërndarjes duhet të pajiset me licencë shpërndarje nga ERE. Kushtet e licencës së një Operatori të Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes përcaktohen në Rregulloren e Licensimit të ERE dhe janë në zbatim të standardeve teknike dhe kërkesave të Kodit të Shpërndarjes.

3. Operatori i sistemit të mbyllur të shpërndarjes, është përgjegjës për disbalancat ashtu si edhe çdo operator i tregut të energjisë elektrike.

### **Neni 8**

#### **Amendime të Rregullores**

Këto Rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s.

### **Neni 9**

#### **Hyrja në Fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga Bordi i ERE-s.